



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:281129
Datë: 21.01.2025
Numri i dokumentit: 06734073

C.nr.906/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen juridiko-civile të paditësit Z. H. nga P., të cilin i përfaqëson Shpetim Sadiku av. nga Lipjani, me autorizim zëvendësues, ndaj të paditurës Limak Kosova (International Airoport Prishtina JSC) me seli ne fshatin Vrellë të Goleshit, të cilën e përfaqëson Leonora Fejzullahu, me autorizim, për shkak të kompenzimit të t'ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.22.10.2024, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa me dt.15.01.2025 merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e precizuar e paditësit Z. H. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Limak Kosova (International Airoport Prishtina JSC) me seli në Vrellë të Goleshit, që paditësit t'ia paguaj në emër të diferencës së pagës prej 350-€ të pa paguara për periudhën 23.08.2019 deri me dt.17.09.2024 në shumë prej 18,196.25-€, si dhe çdo muaj vijues në emër të pagës bruto pas nivelizimit të pagës shumë prej 900.00-€, me kamat prej 8% nga data e paraqitjes së paditë dt.19.12.2023 e deri tek pagesa definitive, duke filluar nga dt.17.09.2024 si dhe në emër të kamatës së arritshme në emër të diferencës së pagës shumë prej 3,770.81-€. Ndërsa në llogarinë e Trustit Pensional në emër të paditësit t'ia paguaj shumën prej 1,067.50-€, në emër të Tatimit në Burim në llogari të ATK-së, shumë prej 2,086.25-€.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi Z. H. nga P. në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi ndaj të paditurës Limak Kosova (International Airoport Prishtina JSC) me seli ne fshatin Vrellë të Goleshit, për shkak të kompenzimit të të ardhurave personale.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Në padi ka theksuar se e paditura me Shoqatën e Sindikatës e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", kanë lidhur marrëveshje më datë 23 gusht 2019, të cilën marrëveshje e paditura nuk e zbaton ndaj tani paditësit. Në mbështetje të marrëveshjes paditësit nuk i është realizuar diferenca e pagës mujore e që lidhet me piken 2 të marrëveshjes, citojmë nivelin e pagave që është zbritur në vitin 2014, në të gjitha shërbimet, do të rregullohet dhe do të aplikohet niveli i atëhershëm për të gjitha pozitat. Kryetari i SH.S.ANP"Adem Jashari", ka kërkuar disa herë tek punëdhënësi që të realizohet marrëveshja detyruese në tersi për punonjësit, por paditësit deri tani nuk i është mundësuar diferenca e pagës që i është zbritur në vitin 2014. Nivelizimin pagave sipas pikës 2 të marrëveshjes është paraparë të fillon më diferencën e pagës nga muaj gusht 2019, për punonjësit që janë zbritur pagat në vitin 2014. Nga të cekurat shihet

qartë se nuk është realizuar diferenca e pagës nga e paditura tani paditësit dhe kërkon që retroaktivisht nga muaj gusht i vitit 2019, të kompensohet diferenca e pagës në shumë prej 350 Euro dhe ti ofrohet aneks kontrata për nënshkrim me diferencën e pagës sipas kontratës së punës të vitit 2014, ashtu siç kanë vepruar me ofrimin e aneks kontratës të punës për punonjësit tjerë e që lidhen me diferencën e pagave që janë zbritur punonjësve në vitin 2014. E paditura - punëdhënësi nuk po e zbaton marrëveshjen e nënshkruar me këtë marrëveshje e paditura është dashur ta zbaton deri tani dhe ta paguan diferencën e pagës për tani paditësin. Paditësi në bazë të Kontratave të Punës e dëshmon Kontratën e Punës pa zbritje të pagës dhe Kontratën e punës me zbritje të pagës të vitit 2014. Paditësi i ka propozuar Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan që pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave të propozuara të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit.

Me parashtrësën e dt.21.10.2024 pala paditëse e ka bërë precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë më konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe precizimit të bërë. Baza juridike e padisë mbështetet në marrëveshjen e dt.23.08.2019 dhe njëherit kjo nuk është procesverbal por është një marrëveshje e cila ka buruar si rezultat i një organizimi sindikal punëdhënësi dhe punëmarrësi i përfaqësuar nga sindikata në emër të ndërprerjes së marrëveshjes sindikale kanë arritur marrëveshje e ndër to është edhe nivilizimi i pagave sipas pikës II e që në pasusin e fundit të pikës II punëdhënësi këtë rast e paditura ka marur për obligim që nivilizimi i pagave ka efekt të menjëhershëm dhe aplikohet në pagën e muajit Gusht të vitit 2019 dhe ka paraparë që në rast të mos kompenzimit për shkaqe teknike kompensimi të vazhdojë të bëhet nga muaji Shtator 2019. Edhe për kundër kësaj e paditura nga viti 2019 deri më tani vazhdon të mos e respektoj këtë marrëveshje për të cilën ka qenë inicuese dhe në të njëjtën kohë është nënshkruese e saj. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e precizuar të paditësit ta miratojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas TA-se dhe i ka specifikuar me parashtrësën e datës për precizim të datës 24.11.2023.

Në të përgjigjur në padi në formë të shkruar e paditura i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e paditëseve si të pabazuar dhe ka shtuar se Kontrata Kolektive nuk është në fuqi pas datës 31.12.2017 pasi që Oda Ekonomike e Kosovës është tërhequr nga Kontrata Kolektive dhe edhe në kohën sa ka qenë në fuqi ajo nuk ka qenë e vlefshme për të paditurën sepse nuk e ka nënshkruar e paditura asnjëherë dhe se kjo kontratë duhet të vlejë vetëm për palët nënshkruese të cilët i marrin detyrimet kontraktuese. Sa i përket orëve gjate fundjavës siç kanë pretenduar paditësit punonjësit të cilët i kanë kaluar 40 ore në javë dhe të cilët nuk punojnë punën me ndërrime dhe kanë punuar vetëm gjate fundjavës vetëm këtyre ju takon kompensimi nëni 56 pika.5.2 e Ligjit të Punës dhe ata paditës që kanë punuar për orar të rregullt të punës përbën zbatim të dispozitës së lartë përmendur andaj ka propozuar që të hedhet padia e paditëseve.

Në fjalën përfundimtare e autorizuar e të paditurës ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigje në padi dhe se fjalën përfundimtare më gjerësisht do ta paraqesë me shkrim brenda afati 7 ditor, gjë që e njëjta nuk e ka paraqitur.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave dhe atë me shiqimin dhe leximin e kërkesës së kryetarit të sindikatës drejtuar të paditurës të datës 13.03.2019 për kompensimin e benifiteve në punë, me shiqimin dhe leximin e shkresës tjetër drejtuar të paditurës që ka kërkuar përgjigje për kërkesat ligjore, me shiqimin dhe leximin e shkresës së të paditurës të datës 22.03.2019 drejtuar kryetarit të sindikatës së punëtorëve, me shiqimin dhe leximin e kontratës së punës të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës e datës 04.04.2011 dhe kontratës tjetër të dt.04.04.2020 dhe anekseve shtesë si dhe shkresave të bashkangjitura kontratës si pasqyra e trustit pensional dhe pasqyra bankare, si dhe me shiqimin dhe leximin i ekspertizës financiare të datës 17.09.2024 të ekspertit

Granit Bytyqi, e të cilat prova gjykata i administroi dhe i vlerësoi në pajtim me nenin 8 të LPK-së, ku vërtetoi këtë gjendje faktike:

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është i punësuar tek e paditura, raport ky kontraktual i rregulluar përmes kontratave të punës, mirëpo ndërmjet ndërgjyqësve kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë, gjegjësisht, marrëveshja e arritur që ka rrjedhur nga procesverbali i takimit mes të SHSP ANP “Adem Jashari” dhe menagjmentit të LKIA të dt.23.08.2019, dhe nëse paditësit në bazë të kësaj gëzojnë të drejtën e përfitimit të këtyre shtesave.

Nga procesverbali i takimit mes të SH.S.P. ANP “Adem Jashari” dhe menaxhmentit të LKIA të dt.23.08.2019, gjykata vërtetoi faktin se përfaqësuesit e të paditurës, si punëdhënëse, dhe përfaqësuesit e sindikatës së punëtorëve, ndër ta edhe paditësit, nga takimi i mbajtur me dt.23.08.2019, kishin shprehur gatishmëri për të zgjidhur kërkesat e punëtorëve ku ishte arritur dakordimi për 8 pika, ndër të tjera me pikën 2 parashihej: Nivelizimi i pagave, ku përcaktohet se: *“Niveli i pagave që është zbritur në vitin 2014 në të gjitha shërbimet, do të rregullohet dhe do të aplikohet niveli i atëhershëm për të gjitha pozitat,..... Nivelizimi i pagave ka efekt të menjëhershëm, pra aplikohet në pagën e muajit gusht 2019, por nëse për çfarëdo arsye teknike nuk do të mund të finalizohet, kompensimi i shumës do të paguhet me pagën e muajit shtator 2019.”*

Nga kërkesa për implementimin e marrëveshjes në tërësi e dt.22.11.2019, gjykata vërtetoi faktin se kryetari i SHS ANP Bashkim Latifi, i kishte drejtuar kërkesë për implementimin e marrëveshjes së dt.23.08.2019, Drejtorit menaxhues ANP-LKIA Haldun Kokturk dhe Drejtorit Basri Zuka, duke përfshirë pjesëtarët, punëtorët të cilët përfitojnë nga kjo marrëveshje nga secili departament duke kërkuar rishikimin e pagave të punëtorëve dhe kërkuar nivelizimin e tyre, ndër ta të përfshirë edhe paditësit.

Për paditësin Z. H., nga kontrata e punës e lidhur mes paditësit dhe të paditures duke filluar nga data 04.04.2020 për periudhë të pacaktuar bashkangjitur me aneksin e saj në gjuhën shqipe dhe angleze, pasqyra e llogarisë së trustit për paditësin, pasqyra e llogarisë bankare për paditësin, gjykata vërtetoi faktin se ndërgjyqësit raportet e tyre kontraktuale i kishin rregulluar përmes kontratës së punës, ashtu që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në bazë të kontratës së punës, në vendin e punës me të drejta dhe detyra të përshkruara sikurse në kontratë, përkatësisht Cargo Zevendes Menaxher, ndërsa nga pasqyra e llogarisë së trustit dhe pasqyrat bankare gjykata vërtetoi faktin se paditësi përgjatë periudhës së punës ka pranuar pagën bazë të pacaktuar sikurse në kontratë, në vlerë 550 euro, mirëpo nuk ka pranuar shtesat e tjera të cilat paditësi pretendon se i takojnë sipas marrëveshjes së datës 23.08.2019.

Nga ekspertiza financiare e hartuar nga eksperti gjyqësor Granit Bytyqi me dt.17.09.2024, detyrë e të cilit ishte përlllogaritja përkatësisht nivelizimi i pagës dhe atë për periodën 23.08.2019 e deri në hartimin e ekspertizës, diferencën prej 350 euro në muaj duke përfshirë edhe kamatën ligjore në lartësi prej 8 %. Po ashtu detyrë e ekspertit ishte që në këtë diferencë të bëhet edhe kalkulimi i kontributeve pensionale si dhe tatimi në burim, gjykata konstatoi se sipas ekspertizës së punuar nga eksperti në fjalë është konstatuar se për shkak të mos realizimit të të ardhurave personale për periodën kohore prej dt.23.08.2019 e deri më dt.17.09.2024 (si datë e hartimit të ekspertizës), paditësit i takojnë shumat respektive sikurse në ekspertizën e punuar.

Baza Ligjore

Me nenin 10 par.1 të këtij ligji parashihet që: *Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Me nenin 11 par.1.8 parashihet se: Kontrata e Punës përmban, lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër.*

Ndërsa, me nenin 55 par. 1 të LP-së, Paga, kompensimi i pagës dhe të ardhurat e tjera, është paraparë se: *I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ndërsa me par. 2 Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuarit i*

realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Mbi bazën e provave të administruara, e të cilave ua fali besimin, gjykata erdhi deri tek përfundimi se paditësi ishte në marrëdhënie pune tek e paditura dhe marrëdhëniet e tyre kontraktuale i kishin të rregulluara me kontrata respektive të punës, të përshkruara sikurse më lartë me detyra të punës dhe pagë bazë të përcaktuara sikurse në kontratat e punës, ku palët kontraktuese janë pajtuar për kushtet dhe detyrat e tjera të punës, ndër të tjera edhe paga e përcaktuar sikurse në kontratë nga edhe rezulton se paditësi ka qenë i njoftuar lidhur me kushtet e punësimit, ku nga shqyrtimi i provave të theksuara më lartë dhe shqyrtimi i shkresave të lëndës, kjo gjykatë erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar për arsye se edhe pse mes palëve nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përgjatë periudhës kontestuese ka realizuar pagën e kontraktuar sikurse me kontratën e punës, fakt kontestues u paraqit baza juridike për realizimin e kërkesës së paditësit, çështja e mosrespektimit të marrëveshjes së arritur me dt.23.08.2019 në mes të përfaqësuesve të të paditurës dhe të paditësve.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se ndërgjyqësit në bazë të vullnetit të lirë kanë lidhur kontratë pune në bazë të dispozitave të Ligjit të Punës, nga edhe rezulton se në rastin konkret janë respektuar kriteret ligjore, pasi që kontratat e punës të lidhur në mes të paditësve dhe të paditurës kanë përfshirë periudhën kohore të punësimit për të cilën është lidhur kontrata, e ndër të tjera edhe paga bazë e përcaktuar sikurse me këto kontrata, për çka paditësi ka qenë i vetëdijshëm për lartësinë e pagës së tij me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate të punës, të cilën e ka pranuar dhe nënshkruar pa vërejtje.

Duke pasur parasysh edhe nenin 4 të LMD-së, parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë, e poashtu edhe nenin 10 të LP-së, ku njëri nga elementet që duhet t'i përmbajë kontrata e punës është edhe lartësia e pagës bazë dhe në rastin konkret palët kontraktuese kanë qenë të njoftuara me këtë fakt, prandaj marrëdhënia e punës sipas vlerësimit të gjykatës është një marrëdhënie që rregullohet juridikisht përmes kontratës së punës bazuar në Ligjin e Punës. Kontrata e punës përfaqëson një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhënien e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Përmes saj punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të punëdhënësit, në kundërvlerë të pagës mujore. Ligji i punës në tërësinë e tij, nuk parasheh mënyrë tjetër të themelimit të marrëdhënies së punës përpos se me kontratë të punës, e cila mund të lidhet në afat të caktuar, apo të pacaktuar. Meqë kontrata e punës ka paraparë ndër të tjera edhe lartësinë e pagës bazë për secilin nga paditësit, ndryshimi i kësaj page do të vinte në shprehje vetëm po që se e paditura dhe paditësi do të kishin vullnet për të ndryshuar një marrëdhënie të tillë kontraktuale, dhe në rastin konkret ka munguar vullneti i punëdhënësit – të paditurës që ta ndryshojë kushtet e kontratës, andaj marrëveshja në të cilën paditësi pretendonë se i takon ky shpërblim për realizimin e diferencës në vlerë prej 350 euro, për çdo muaj është i paqëndrueshëm, pasi që vendimi për detyrimin e kompensimit të tillë nga ana e gjykatës do të ishte imponim i vullnetit të palëve dhe shkelje e parimeve kryesore të marrëdhënieve kontraktuale, pasi që me ligj parashihen mënyrat e rregullimit dhe ndryshimit të raporteve kontraktuale, ndërsa marrëveshja e arritur nuk e ka fuqinë e ligjit, andaj edhe kërkesa e paditësit nuk ka mbështetje ligjore për një vendosje ndryshe.

Për gjykatën, takimi i mbajtur me dt.23.08.2019, në mes të përfaqësuesve të palëve, ishte i karakterit njoftues me qëllim që të adresohen shqetësimet që punëtorët e të paditurës kishin shfaqur për çka palët ishin dakorduar që do të përpiqen që për të njëjtat të gjejnë zgjidhje dhe ti tejkalojnë, e në ato pika të arritur dhe të dakorduara ishte paraparë me pikën 2 edhe çështja e nivelizimit të pagave që paditësi e ka paraqitur si kërkesë në këtë procedurë.

Me rastin e vendosjes gjykata ka vlerësuar pretendimet e palës paditëse mirëpo të njëjtat pretendime i ka refuzuar si të pa bazuara me arsyetimet e cekura më lart duke vlerësuar se

marrëveshja mes palëve për të rregulluar koeficientin e punëtorëve ka qenë një marrëveshje që është dashur paditura në të ardhmen të merre ndonjë vendim brenda institucionit për rritjen e pagës bazuar në marrëveshjen e arritur dhe vetëm marrëveshja e arritur në mënyrë të përgjithshme nuk paraqet bazë të mjaftueshme ligjore për aprovimin e kërkesës së paditësit. Në këtë drejtim ekspertiza financiare e ekspertit të angazhuar nuk paraqet bazë të mjaftueshme për aprovimin e kërkesës së paditësit sepse kjo vetëm ka saktësuar lartësinë e kërkesës për periudhën kontestuese nëse do të kishte bazë ligjore padia e paditësit.

Meqenëse pala paditëse e ka humbur kontestin dhe e paditura e ka fituar kontestin por nuk ika kërkuar shpenzimet e procedurës për këtë arsye gjykata konform nenit 450 të LPK-së vendosi që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të dispozitave të lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN
C.nr.906/23 me dt.15.01.2025

GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:281129
Datë: 21.01.2025
Numri i dokumentit: 06734073